



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

16. 02. 2023

M-020/04-36523/23, më _____

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008) dhe nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit merr këtë:

V E N D I M

1. **Miratohet** themelimi i Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave nga subjektet afariste për tu pajisur me certifikatë për nivelin e zhurmës së lejuar.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, komisioni është në këtë përbërje:
 1. Shpresa Bytyqi, Drejtorja e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit;
 2. Qendresa Ramadani Kupina, Drejtorja e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit;
 3. Krenare Mjekiqi, Drejtorja e Administratës;
 4. Makfired Abdullahu, Drejtorja e Urbanizmit;
 5. Shkurta Hetemi, Drejtorja e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit.
3. Detyrë e Komisionit të cekur si në pikën 2 të këtij Vendimi, është shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave të çdo subjekti afarist të gastronomisë (kafene, restorante, bare, klubet e natës etj), për tu pajisur me certifikatë për nivelin maksimal të decibelëve të lejuar (zhurmës), konform Rregullores për orarin e punës dhe mbrojtjen nga ndotja akustike në sektorin e gastronomisë nr. 01-110/04-277218/22 e dt. 29.12.2022.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

U dorëzohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- DSHPMSh-së;
- Qendrës për Shërbim me Qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

